

KONTRATË DHURIMI KUOTE KAPITALI

E lidhur në Tiranë, sot më 22 / 01 / 2018, nga dhe ndërmjet:

Dhuruesi: **Z. Elton Çekrezi**, shtetas shqiptar, lindur me 03.11.1985 ne Çepe, Elbasan dhe banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025905057 dhe nr. personal I51103046R, madhor e me zotësi te plote juridike per te vepruar;

dhe

Pranuesi: **Z. Anduel Çekrezi**, shtetas shqiptar, lindur më 03.08.1990 ne Çepe, Elbasan dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032319223 dhe nr. personal J00803074O, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

MEQENESE:


- A. Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit janë ortakë të shoqërisë tregtare "EUROELEKTRA" Sh.P.K., një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L01808013Q, me seli ne adresen: Tirane, Vaqarr, Rruga Prush 1041, Numer pasurie 151/154, Zona Kadastrale 3064, (me poshte referuar "*Shoqëria*"), dhe zotërojnë perkatesisht Dhuruesi 60% te kuotave te kapitalit dhe Pranuesi i Dhurimit 40% te kuotave te kapitalit;
- B. Dhuruesi deshiron t'i dhuroje Pranuesit te Dhurimit dhe ky i fundit deshiron te pranoje dhurimin e 9% (nente përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Asamblese se Ortakëve te Shoqërisë, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhuruesi i dhuron Pranuesit te Dhurimit i cili pranon dhurimin dhe fiton pronësinë mbi 9% (nente përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë.
2. Dhurimi behet pa kushte, kufizime apo barra dhe kalimi i pronësisë mbi pjesën e kapitalit konsiderohet i kryer ne momentin e lidhjes se kesaj Kontrate.
3. Pas lidhjes se kesaj Kontrate dhe regjistrimit te saj ne regjistrat perkatës, Dhuruesi do te zoteroje 51% (pesedhete e nje përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë dhe Pranuesi i Dhurimit do te zoteroje 49% (dyzet e nente përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë.
4. Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te Kuotes objekt të kesaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

DHURUESI
Elton Çekrezi



PRANUESI
Anduel Çekrezi

